

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakti nga procesverbali, i-III, i Kuvendit të Komunës, i mbajtur më datën 03.04.2025, ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Miranda Shabani, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Fidan Berisha, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungon: Doruntina Jashari.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Ekrem Berjani - Drejtor për Zhvillim Ekonomik, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Ali Topalli - Drejtor për Kulturë Rini e Sport, Parayll Zogjani - Drejtor për Planifikim Urban, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Ardit Sekiraça - Drejtor për Shërbime Publike e Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi, Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Hysen Sllamniku - Drejtor për Shëndetësi dhe Driton Ademi - Drejtor për Teknologji Inovacion dhe Integritet Evropiane.

Të tjerë: Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 06.03.2025.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.
4. Shqyrtimi i rekomandimit për shfuqizimin e vendimit me Nr. 123 të datës 23.10.2024.
5. Propozim për shqyrtimin e shpërndarjes së buxhetit nga rritja e të hyrave vetjake për vitin 2024
6. Propozim për lejimin dhe bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara të vitit 2024 në buxhetin e vitit 2025.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Materialin e keni marrur me kohë. Kjo është mbledhja e tretë e vitit 2025, me këtë rendë të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës dhe i njoftoj të gjithë që pas kërkesës së televizionit ATV, i cili është prezent, mbledhjen është duke e përcjellur live, i përshëndes mediat dhe organizatat jo qeveritare. Unë pyes, a ka dikush ndonjë propozim sa i përket rendit të ditës? Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çoi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës.

U votua me: unanimitet, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, me lejen e juaj të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, dua që të ia jap fjalën z. Artan Asllanit, i cili është çertifikuar zyrtarisht, si deputet i Republikës së Kosovës, sepse kërkojë që të na përshëndet për bashkëpunimin të cilin e kemi pasur për këto vite dhe të lirohet nga mbledhja e sotme, sepse e ka dorëzuar edhe dorëheqjen.

Artan Asllani: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar kolegë asambleistë, të nderuar përfaqësues të ekzekutivit dhe media, sot në këtë mbledhje të fundit, për mua si asambleist në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës, dua të ndaj disa fjalë për gjatë rrugëtimit tim për gati katër vjet si asambleist në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës. Ka qenë një periudhë me plotë sfida, por edhe me shumë momente të rëndësishme, që mua personalisht më kanë ndihmuar të rritem si person dhe si përfaqësues i qytetarëve. Dua t'ju falënderoj të gjithë kolegëve për bashkëpunimin, debatet konstruktive dhe për angazhimin tonë institucional, sepse ka qenë shumë i rëndësishëm për qytetarët e Fushë-Kosovës. Çdo herë jemi munduar që ta kemi një qëllim të përbashkët dhe qëllimi ynë ka qenë përmirësimi i jetesës së qytetarëve të komunës sonë. Një falënderim i veçantë për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, z. Ali Ismaili, për drejtimin e punës, angazhimin e tij për krijimin e një atmosfere dhe një mjedisi demokratik dhe të hapur, për diskutim për secilin prej nesh. Falënderoj secilin Grup Parlamentarë për bashkëpunimin dhe të gjitha mundësitë që na i kanë dhënë për këtë rrugëtim që të vazhdojmë më tutje. Ekzekutivi i Komunës së Fushë-Kosovës, i cili ka qenë i gatshëm për t'i adresuar kërkesat dhe shqetësimet e qytetarëve që unë kam përfaqësuar, nuk ka qenë e lehtë çdo herë për ne. Por, me vet faktin që jemi munduar t'i realizojmë disa nga kërkesat e komunitetit Ashkali dhe qytetarëve tjerë, mua më jep shpresë dhe motivim për të vazhduar punën time në nivel më të lartë. Gjatë këtyre katër viteve, unë kam qëndruar besnik i këtij koalicioni. Jo për përfitime personale, por për një qëllim të vetëm, që të ndihmoj komunitetin Ashkali dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës. Unë kam hyrë në këtë sallë duke pasur një mision të qartë. Sot, derisa po largohem nga kjo pozitë, mund të them me krenari se nuk kam devijuar nga ai mision, por kam ngritur zërin për komunitetin tim dhe për mundësitë e vazhdueshme që na takojnë me të drejtë. Largimi im nga kjo pozitë nuk do të thotë që po largohem nga angazhimi im për qytetarët e komunitetit tim. Përkundrazi, është vetëm një hap tjetër në këtë rrugëtim. Në mandatin tim si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, unë do ta vazhdoj punën për Kosovën, për komunitetin Ashkali dhe për Fushë-Kosovën. Do të jem zëri i atyre që mbeten pa u dëgjuar dhe ju siguroj se do mundohem t'ju siguroj më shumë mbështetje dhe një jetë më të drejtë për të gjithë. Unë këtë nuk e shoh si ndarje, por si zgjerim të bashkëpunimit tonë. Raportet tona duhet të forcohen edhe më shumë, sepse vetëm duke punuar së bashku mund të arrijmë ndryshimin që duam për shoqërinë tonë. Unë do të jem atje, për ju, zëri i juaj dhe do të luftoj për drejtat e juaja me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, konkretisht

qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës. Faleminderit për këto katër vite punë dhe bashkëpunim. Ju falënderoj të gjithëve.

Pika një (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 06.03.2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoj anëtarët ta marrin fjalën nëse kanë ndonjë vërejtje.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, duhet ta respektoni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Kuvendit.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, duhet ta respektoni Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren e Kuvendit.

Hasan Ismajli: Kam vërejtje tek faqja katër, rreshti i parafundit, është dashur të jetë "nuk është dashur të jetë" tek pyetja e Drejtorisë së Shëndetësisë, faqe trembëdhjetë, rreshti i dytë, faqe tetëmbëdhjetë, rreshti i tretë i parafundit duhet të jetë "në ditët në vijim".

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e çoi në votim për aprovimin e 'Ekstraktin e Procesverbalit me ndryshimin që e dha asamblëisti nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datën 06.03.2025.

U votua me: katërmëbëdhjetë vota 'për', tetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datën 06.03.2025.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoj anëtarët ta marrin fjalën.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, uroj edhe kolegun tonë, z. Artan Asllanin, për certifikimin e tij si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, dua ta falënderoj për bashkëpunimin që kemi pasur deri tash. Të dashur kolegë dhe të gjithë të pranishëm, të gjitha pyetjet i kam për një drejtor, por realisht përgjigje kërkoj nga të gjithë ata që kanë përgjigje për këtë çështje. Po filloj prej dhënies në shfrytëzim të një prone komunale, e cila nuk është larg objektit të Komunës këtu në lagjen e Bresjes, e cila ishte në lidhje me ndërtimin e një xhamie, ku fillimisht, materialet të cilat zyrtarisht janë prezantuar nga ekzekutivi, kemi të bëjmë me një ngastër, afërsisht 17 ari dhe ne kur kemi hulumtuar dhe i kemi parë në kanale zyrtare, njëri prej tyre edhe Geo-portali, nuk ka figuruar kjo ngastër prej 27 ari, në të cilën kemi diskutuar, por është mbrojtur nga ekzekutivi këtu dhe është tërhequr edhe vëmendja e mediave për këtë çështje, ku jam kontaktuar edhe unë nga disa media. Këtu ka ndodhur një fenomen shumë i çuditshëm, ku sinqerisht Kuvendi i Komunës duhet të mbajë një mbledhje të veçantë vetëm për këtë çështje, sepse është ndërhyrë në sistem, në dokumentacion lidhur me këtë ngastër. Të dashur kolegë, këtë mund ta shikoni në Geo-portali, që ajo ngastër është kthyer në 27 ari dhe është një ngastër e vetme, nuk është një ngastër e ndarë ashtu siç na është prezantuar ne në Kuvend. Kjo është kthyer në gjendjen e mëparshme. Pyetja është për Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës dhe tek bartësit tjerë, sepse këto ndryshime vërtetohen se janë kthyer në gjendjen e mëparshme. Nëse ka mundësi, a mund të na përgjigjet dikush se si është e mundur që një pronë komunale të ndryshojë titullari i saj, numri i ngastrës, të parcelizohet dhe pastaj të kthehet në gjendjen e mëparshme, në këtë formë kaq të lehtë? Një pyetje tjetër, e cila kam me vazhduar me përsëritje deri sa të kem qasje në dokumente zyrtare, ka të bëjë po ashtu me një ngastër, ku ne supozojmë që ka qenë pronë komunale dhe vitet e fundit kjo pronë është bërë pronë private. Nga

Agjencia Kadastrale na është thënë që titullar i kësaj prone është një privat dhe ne kemi kërkuar nga drejtori që të na jep, qoftë një vendim të gjykatës, qoftë Kuvendit të Komunës që kjo pronë ka kaluar nga prona komunale në pronë private, ose demantimin që kjo pronë asnjëherë nuk ka qenë pronë komunale. Nëse nuk ka qenë, atëherë ne nuk kemi mundur të ndalemi asnjëherë deri sa të marrim një përgjigje lidhur me këtë çështje për tjetërsimin e pronës komunale. Një pyetje tjetër kemi nga banorët e fshatit Bardh i Vogël, të cilët kërkojnë që objekti i ambulancës të ridestinohet për nevojat e komunitetit, për arsye se ajo ka mbetur e pa shfrytëzuar për një kohë të gjatë dhe që realisht kemi nevojë për të. Një kërkesë tjetër ka të bëjë me stacionin policor, e cila ka të bëjë me objektin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare në lagjen 'Dardania' në Fushë-Kosovë, afër Kompleksit 300, që të jepet në shfrytëzim Policisë së Kosovës, për shfrytëzim si nënstacion dhe nuk është kthyer asnjë përgjigje nga ekzekutivi. Pyes, a kanë filluar procedurat për të kthyer përgjigje stacionit policor në lidhje me këtë kërkesë, sepse deri tash nuk ka pasur.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje, uroj edhe kolegun tonë, z. Artan Asllanin, për certifikimin e tij si deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, falënderojmë për bashkëpunimin. Këtë javë kemi qenë pre e mediave për çështjen të cilën e ngriti edhe kolegu z. Durim Hajra. Pyes Drejtorinë e Kadastrit kur ka ardhur kjo pika e xhamisë, aty u vërejt që në atë pronë ka ndërhyrje. Unë mbaj mend se kam kërkuar sqarime dhe ju na keni thënë se fletën poseduese e ka komuna dhe komuna është pronari. Me pamje në Geo-portalin vërehet se ka ndarje. Unë e kam pyetur edhe Drejtorin e Urbanizmit se me këto dokumente të cilat i kemi përpara, a jepni ju leje, e i cili na u është përgjigjur që po, mirëpo në ndërkohë aty po del se ka ndërhyrje. Pyetja ime është: A keni qenë në dijeni se aty ka ndërhyrje në pronë? Po dua ta parashtroj një pyetje: A ka dikush të drejtë që të hyjë kështu në ngastra komunale dhe t'i shpërndajë dhe t'i ribashkojë ashtu siç kanë nevojë? A ekziston një rregull, meqë je drejtor aty, sepse jemi duke folur për një pronë komunale? Pyes, a e keni ditur që ka ndërhyrje, sepse edhe në mbledhjet e kaluara kemi bërë këtë pyetje. Kjo vlen për Drejtorin e Kadastrit dhe Drejtorin e Urbanizmit, sepse edhe ai ka thënë se dokumentacioni është në rregull, përkundër të gjitha shqetësimeve që i kemi dhënë. Po vazhdoj me pyetjet për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Kontrata për mbjelljen e drunjëve, kur përfundon kjo kontratë? Në mbledhjen e kaluar, kur folëm për rrethojat e drunjeve, i keni zbritur në 2.5, arsyetimi juaj ka qenë që na mjafton për të gjithë drunjët të kenë rrethoj, mu duk e habitshme se si ka mundësi, kur ju për gjysmën e drunjeve keni ndarë dhe për gjysmën tjetër jo. Unë mendoj që secili dru duhet të ketë rrethoj për t'u mbrojtur, jo disa po, disa jo. Dua të parashtroj pyetje për Drejtorin e Arsimit, ku një qytetar e ka ngritur një shqetësim me video, tek rruga 'Amir Elmazi', Aneksi 3, ku thotë se nga stina e vjeshtës, ku e keni vendosur kabillon e rrymës për të dërguar ndriçimin në shkollë, thotë se u dëmtua rruga dhe askush nuk ka ardhur më që ta kthejë në gjendjen e ekzistuese, që një kohë të gjatë. Rregullorja për varrezat ka kaluar të gjitha filtrat, mirëpo ne kemi informacion që, përsëri Këshilli i Bashkësisë Islame në Kosovës, po negocion për financimin e tyre, nëse ne e kemi përgatitur një rregullore, e cila është e gatshme, pse duhet të marrë Kryetari këtë të drejtë dhe të negociojë? Sepse po del në pah që është duke u bërë politikë me këtë punë dhe ne si Kuvend nuk jemi të interesuar për politikë, sepse unanimisht kemi votuar që qytetarët të marrin shërbimet të cilat u takojnë, e jo të provohet të tregoni që, pa lejen time, ju nuk mund të vazhdoni tutje. Pyetja tjetër e kam për hapësirat publike. Unë mbaj mend që Nënkryetari i Komunës ka thënë se nga muaji mars, do kemi një plan dhe do të fillojmë ta zbatojmë, mirëpo unë nuk po shoh asgjë tjetër përveç një terase në rrugën 'Xhemajl Mustafa', e cila u bë imediale, mirëpo përveç disa fotografive që kanë bërë disa punëtorë, ajo rrugë është komplet e uzurpuar dhe nuk ka më vazhdim të punëve. Pyetja ime është: Si ka mundësi, që në të njëjtën rrugë, tek një lokal të ndërhyhet dhe tek një lokal tjetër jo, ku drejtori juaj e ka pranuar

se ato të gjitha janë pa leje? Drejtoria e Shërbimeve Publike, i nderuar drejtor, në Bardh të Madh, pjesa dërrmuese e ndriçimit mungon, a jeni të informuar për këtë pjesë dhe a keni mundësi të na tregoni nëse do të ndërhyhet dhe a keni ndonjë plan? Për Drejtorin e Administratës, i nderuar, kam nevojë që ta kem një listë të drejtorëve të drejtorive në Komunën e Fushë-Kosovës, sepse nuk po e kam të qartë, sepse rrugës dëgjoj “hyri, u largua” dhe po e kam të paqartë kujt të drejtohem. Drejtoria për Kulturë, i nderuar, herën e kaluar na keni premtuar se do të dilni dhe do t’i vizitoni sallat e sportit, pyetja ime është: A keni dalë t’i shihni dhe cilët janë hapat që keni ndërmarrë për të ndryshuar gjendjen që kanë mbetur? Po ashtu, pash një fotografi ku ju kishit dhënë një iftar për familjet e dëshmorëve, pyetja ime është: Cila është arsyeja pas 26 viteve që ju ra ndërmend t’i thirrni për një iftar, për t’i nderuar disa familje të dëshmorëve? Cila është arsyeja pas 26 viteve? Çka ka ndodhur, sepse të gjithë e dimë se si janë trajtuar për 26 vite? Dua ta parashtoj edhe një pyetje për Drejtorin e Inspektoriatit: Drejtor, urime për pozitën e re, pres më shumë punë. Të gjitha problemet që i diskutoj, nga rregullorja që nuk ka zbatim në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, qoftë për lirim të hapësirave, qoftë për deponitë që po krijohen, shtizat i drejtojmë tek drejtoria juaj. Nuk i di shkaqet pse drejtori i cili ka qenë, nuk është më, po ashtu dua ta di: A keni ndonjë plan konkret ku do të qaseni këtyre problemeve në qytet, sepse po thuajse 90% është punë e drejtorisë tuaj?

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Urime për pozitën e re z. Donat Zharku - Drejtori i Inspektoriatit, i kam parë disa angazhime të drejtorisë suaj kohën e fundit, në rrjete sociale, kërkoj më shumë punë nga ju sepse drejtori i cili ka qenë nuk ka qenë shumë i angazhuar. Tek lagjet tona, më saktësisht rruga për Kuzmin, aty disa makina pengojnë rrugën ku bëhen shitblerjet, unë kam lajmëruar disa herë edhe më herët, aty uzurpohet rruga, shiten gjera pa afat, kishte qenë mirë me marrë parasysh këtë shqetësim të banorëve.

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Vitin e kaluar kam bërë dy kërkesa për dhënien e një prone, në shfrytëzim apo për t’ia falur për ndërtim xhamie. Kam qenë asambleisti më i zëshëm sa i përket kësaj pike, me dokumentacion dhe fakte përkatëse, ku kam dalë në foltore dhe kam treguar se ligjërisht nuk është në rregull, sepse ka probleme ligjore dhe saktësisht këtu ka ndërhyrje në grafik. Faktikisht, një pjesë e kolektivit nuk ka besuar dhe ka thënë që nuk është e vërtetë kjo. Unë këtu i kam dy e-maila, njëra është nga Drejtoria e Kadastrit, ku thotë se ngastra 1375/0 ka qenë vetëm në fletë poseduese, sepse grafika ka pasur ndërhyrje, thotë se në këtë çështje asnjëherë nuk ka pasur ndërhyrje. Këtë e-mail e kam nga zyrtarja e cila merret me grafik dhe e-maili tjetër, të cilin ua kam dërguar edhe Shefave të Grupeve Parlamentare, është nga Agjencia Kadastrale dhe shkruan se po, në këtë ngastër ka pasur ndërhyrje në vitin 2022 dhe shkruan më 14.03.2025, në orën 9:08, ka pasur ndërhyrje, e cila është kthyer në gjendjen normale, ashtu si ka qenë para ndërhyrjes në grafik. I nderuar Drejtor i Kadastrit, këto janë e-maila zyrtarë. Ju keni dalë në foltore dhe keni thënë për mua se zyrtare është vetëm fleta poseduese dhe jo kopja e planit. Fleta poseduese tregon sa është hapësira, ndërsa kopja e planit tregon pikat, ku fillon dhe ku përfundon ngastra dhe ju, edhe në Kuvend kur e keni sjellë materialin, ka qenë i pavulosur. Unë kur kam thënë që për mua këto dokumente janë falsifikim, ju keni thënë: "Unë mund t’ju padit sepse këto dokumente nuk janë falsifikim". Për mua çdo dokument që vjen në Kuvend i pa nënshkruar dhe i pa vulosur është fals. Kjo ngastër është kthyer në gjendje aktuale dhe dikush duhet të merret me të. Ngastra tjetër, i nderuar Drejtor i Kadastrit, është tek rruga ‘Hysen Xhakolli’,

mos gabofsha, ka qenë një ngastër e cila është dhënë për ndërtim. Aty kanë qenë tri ngastra, bashkim i ngastrave dhe në fund të asaj ngastre ka qenë një ngastër prej 300 m², që është pronë komunale. Këto dokumente i kam të gjitha dhe nëse doni, televizioni ua dha të gjitha. Këtu e keni ngastrën, drejtor, me vija të kuqe, tre ari janë të komunës, e kësaj ngastre ju i keni bashkuar këta tre ari dhe prej 25 ari kanë dalë 28 ari. Vlera ndërtimore e kompanisë, të cilës nuk po dua t'i bëjë reklamë, ka marrë përqindje për 28 ari dhe pastaj e keni kthyer përsëri në gjendjen normale, ashtu si ka qenë, por përqindja është marrë, është ndërtuar edhe për ato 300 m². Këtë fjalë e kam thënë publike dhe kësaj i rri mbrapa. Kushdo që më thirr, jam në gjendje ta dokumentoj. Shkoni në Urbanizëm dhe shikoni kush e ka lëshuar atë leje, sepse aty ekziston edhe fleta poseduese, kopja e planit me 28 ari, por jo me 25, siç është sot në Geo-portal. Këto ndërhyrje, drejtor, i bëjnë zyrtarët që punojnë në drejtorinë tuaj. Ky është një problem shumë i madh dhe duhet të ndërmarrim masa, sidomos në Drejtorinë e Kadastrit. Këtë e them me sigurinë më të madhe dhe me fakte, me dokumentacion. Dua të ngrisë edhe një çështje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, ku këtë pyetje e kam parashtruar edhe në mbledhjen e kaluar. Një ngastër në Bresje, e cila është pronë komunale dhe shfrytëzohet mbi 10 vjet nga një operator privat. Unë kam ngastrën dhe numrin e ngastrës, sepse në mbledhjen e kaluar e kam parashtruar si pyetje dhe më keni thënë se do ta verifikoni. Nëse jo, tash mund ta jap numrin e ngastrës. Pyes, kujt ju ka dhënë me qera, kush paguan, sa paguan qera dhe cili është problemi me këtë ngastër? Prapë me Drejtorinë e Kadastrit, në këtë e-mail, të cilin e ka dërguar zyrtarja e drejtorisë suaj, thotë: "Ua prezantoj, fletën poseduese dhe kopjen e planit" dhe unë juve, i nderuar drejtor, ua kam adresuar një kërkesë zyrtare, e protokolluar me datë 30.09.2024, pikërisht kam kërkuar kopjen e planit të kësaj ngastre 1375/0, për të cilën nuk më keni përgjigjur asnjëherë deri sot.

Migjen Kolshi: Përsëritet për të gjithë në mbledhje. Në bazë të kësaj që u tha nga kolegët, urgjentisht ishte dashur policia dhe prokuroria të ndërmarrin masa.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Kryesues, nuk është aspak në rregull që televizioni i ATV-së të marrë vetëm pyetjet e asambleistëve dhe të mos presë edhe përgjigjet e drejtorëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar, është e drejtë e televizionit që të rrijë dhe të dalë kur të dojë. Ju, i nderuar Drejtor, mundeni të dilni jashtë dhe t'ju thoni, ju lutem, rrini deri sa t'i merrni edhe përgjigjet nga drejtorët, sepse unë nuk e kam atë të drejtë t'ju ndaloj. Unë herën tjetër kur të parashtroni kërkesën, mund të mos ju jap mundësinë të vini pa i marrë dy versionet, edhe të pyetjeve, edhe të përgjigjeve.

Migjen Kolshi: Në bazë të kësaj që u tha nga kolegët, urgjentisht ishte dashur policia dhe prokuroria të ndërmarrin masa, nëse janë të vërteta këto që u thanë nga parafolësit, sepse edhe këta kanë përgjegjësi për fjalët që kanë thënë, sepse prona publike nuk është e askujt, kjo është e tmerrshme. Pyetjen e parë e kam për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Në fshatin Harilaç, nuk e di sa je i informuar, ka ndërprerje të transportit. Unë e di se ndoshta as komuna as kompania nuk kanë llogari për ta mbajtur atë lidhje, por a ka mundësi Komuna t'i subvencionojë ato kompani, sepse ka shumë nxënës dhe qytetarë të fshatit Harilaç? Kishte qenë mirë t'iu ndihmohej kompanive nëse është mundësia. Pyetja tjetër: Kur fillon ndriçimi në fshatin Harilaç, a ka ndonjë datë? Pasi që u planifikua ujësjellësi në fshatin Harilaç, a keni pasur ndonjë takim me

kompaninë rajonale për lidhjen e ujit të pijshëm, pasi që është shumë afër? Mbledhjen e kaluar kam parashtruar një pyetje për një rrugë e cila është planifikuar, rruga 'Hajrulla Zymi' me rrugën 'Amir Elmazi' deri tek rruga 'Pajazit Islami'. Në atë rrugë u hap tenderi dhe ka filluar puna, është hedhur zhavorri, tash u ndërpre. Një kompani që merret me ndërtim e ka rrethuar atë pjesë dhe ua ka vështirësuar kalimtarëve lëvizjen në atë pjesë. Pyes Drejtorinë për Inspektoriat: A do të ndërhyhet në këtë çështje?

Shpend Bardiqi: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Kjo çështje e pronës është shumë serioze, po në komunën tonë si mos me pa prokuroria. Znj. Dardane Sogojeva më herët ka ngritur çështjen për punësimet e të afërmeve të prokurorëve, të cilat po bëhen. Unë pyes Drejtorin e Administratës, a është punësuar ndonjë familjar i ndonjë hetuesi, i cili ka qenë duke e hetuar Komunën e Fushë-Kosovës, ose ndonjë hetues i çfarëdo lloji institucioni të Policisë së Kosovës? Për Drejtorin e Administratës, kjo pyetje është shumë e vështirë, sepse as objektin e komunës nuk e ka në kontroll, sepse objekti është duke pikuar. Në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për rrugët të cilat po dëmtohen, sot po flasim për objektin e komunës, i cili po pikon. Unë nuk e di kush është përgjegjës, por po ju drejtohem ju sepse Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës kanë hequr dorë nga kjo. Në raport, objektin e keni shkruar si një punë mirë të kryer, a jeni të vetëdijshëm që kanë shkruar miliona euro dhe po pikon? Për Drejtorin e Inspektoriatit, gjithmonë kam pasur pyetje për ku është, pse nuk është prezent dhe kam propozuar që drejtorit dhe punonjësve të ju ndalohen komplet pagat. Por po më vjen mirë që është ndërruar Drejtori i Inspektoriatit. Çdo kund janë të hyrat më shumë se sa dënimet që i ka dhënë Drejtori i Inspektoriatit, por do flasim më vonë. Ne kemi kërkuar disa herë listën e pronave publike, por asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje nga asnjë Drejtor i Kadastrit dhe Gjeodezisë. Pashë një qira që marrim prej 1200€, prej pronave publike, një pronë që Komunës së Fushë-Kosovës është dashur t'ia marrë 1200€. A kishim mundur të shihnim listën, specifikisht për këtë qira që e marrim? Pyetja tjetër: Çka ka ndodhur me pronat të cilat janë shtruar me asfalt, ku qytetarët i keni futur në telashe? Rrugët të cilat kanë qenë midis arave dhe tani po kërkohet të shfrytëzohen, pasi qytetarët kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë. Pyes, çka ka ndodhur, sepse para një kohe të kam pyetur dhe ke thënë se jemi në proces të zgjidhjes. A janë kthyer këto rrugë në prona komunale? Nëse janë kthyer, tregoni, sepse del një qytetar i caktuar dhe thotë se nuk mund të kaloni në këtë rrugë, e nëse është rrugë komunale, nuk ka të drejtë të ndalohet askush. Ka një Drejtor me probleme të mëdha. Pyetja tjetër e kam për laboratorët që ka Komuna e Fushë-Kosovës. Unë mes z. Fisnik Sllamnikut dhe Drejtorit të Arsimit, normal që i besoj z. Fisnik Sllamnikut, i cili thotë dy ose katër laboratorë. Nëse neve na kanë tepruar 6.3 milion euro dhe ne nuk i kemi as gjashtë laboratorë në Komunën e Fushë-Kosovës, kjo është pak shqetësuese. Përfundimisht pyes: Sa laboratorë ka? Në Bardh të Madh, nuk ka ngrohje, pyes: Pse nuk ka ngrohje?

Habib Mekolli: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. U përmenden largimi i pengesave dhe uzurpimi i hapësirave publike, këtë nismë e kemi përkrahur që nga viti i kaluar, i kemi parë edhe disa aksione të cilat drejtorja i ka ndërmarrë në terren, por janë shumë të pakta. Nëse është kjo e vërtetë, kisha filluar nga uzurpimet që i bëjnë zyrtarët publik të Komunës së Fushë-Kosovës, konkretisht pas banesave të bardha ku janë tri garazhda dhe kishte qenë mirë të fillohej nga këtu për t'i larguar ato, për t'i shndërruar në hapësira të gjelbra. Janë edhe disa

uzurpime me leje. Më herët kam dëgjuar edhe ankesa prej Drejtorisë së Urbanizmit, sepse Drejtoria e Urbanizmit po lëshon leje për terasa dhe këto uzurpime. Unë po besoj se autoriteti që e ka lëshuar atë leje, ai ka autoritet edhe për ta tërhequr atë leje, sepse janë të jashtëligjshme. Në terren nuk vërehet se ka lirim të hapësirave publike. Nëse ka nevojë për një vendim të Kuvendit, ua dhënë. Me qenë si duhet, ishte dashur të kishte transmetim të drejtpërdrejtë të mbledhjeve dhe për të parë punën dhe mospunën tonë.

Aida Alimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Pyetjen e parë e kam për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës. Të gjithë ne jemi dëshmitarë të disa rregulloreve dhe të një ëorkshop-i, me një shumë të mjeteve mbi 10,000.00€, me një numër prej 30-40 personash të grupeve punuese, të cilët u zotuan që pasi të kthehemi në Kuvend në muajin në vijim, do të vijnë këto rregullore të plotësuara dhe të ndryshuara. Kërkoj të di se çka ka ndodhur me këto rregullore. Pyetja e dytë: Çfarë masash janë marrë për largimin e qenve endacake, të cilat janë rrezik permanent për të gjithë qytetarët? Rruga tek 'Kompleksi Linda 4' qëndron ende e mbyllur dhe askush nuk po merret me këtë problem. Një pyetje tjetër kam edhe për ulëset, të cilat janë vendosur në Komunën e Fushë-Kosovës. Kërkoj ta di në çfarë mënyre është bërë vendosja e tyre, sepse në shumë ndërtesa nuk bëjnë dhe pse ka ndodhur ky diskriminim? Si është bërë ndarja, po kërkojnë ta dinë qytetarët. Sa i përket injorimit të cilin po na bëjnë si Kuvend, Kryetari dhe Nënkryetari i Komunës po shihet, sepse është raporti i Kryetarit dhe kishte qenë etike të paktën të ishte prezent njëri prej tyre dhe të respektonin punën e tyre. Po ashtu, sot e kam të qartë pse nuk kemi pasur qasje asnjëherë në pronat publike, sepse paskan qenë pazare të dikujt tjetër. Dritat mungojnë tek përmendorja e dëshmorit 'Naser Sekiraga', tek rruga 'Hashim Hajdini' përballë stacionit policor. Kërkoj nga Drejtori i Shërbimeve Publike të merret me këtë çështje. Tek Shërbimet Publike, kabllo të rrymës janë rrezik permanent për qytetarët dhe a jeni duke komunikuar me KEDS-in? Po ashtu, tek ndërtesat e komplekseve, ku është duke u ndërtuar përballë rrugës së 'Dardanisë', çka po ndodh?

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Dua të filloj me Drejtorin e Arsimit. Banorët e fshatit Pomozotin duan ta dinë pse nuk është bërë pagesa e nxënësve për minibusat të cilët i dërgojnë në shkollën në Sllatinë. Pyetjen tjetër: A jeni në dijeni se çka po ndodh me shkollën e lënë pas dore, në të cilën po merren lëndë narkotike në fshatin Pomozotin? Studentët që dy muaj kanë aplikuar për bursa për subvencione dhe pse nuk janë bërë pagesat ende? Drejtoria e Urbanizmit, a keni mundësi të më tregoni sa ndërtime janë pa leje në Komunën e Fushë-Kosovës? Për Drejtorin e Inspektoriatit, sa ndërtesa janë që nuk i keni pranuar teknikisht të ndërtesave dhe lokaleve? Sa i përket qenve endacake, a keni ndërmarrë diçka, sepse tani po bëhet vonë ashtu siç u bë për vajzën time, ku vazhdimisht kam kërkuar pengesa tek shkolla 'Mihal Grameno' dhe nuk u mor asgjë parasysh deri sa u bë e madhe. Në fshatin Sllatinë e Vogël, banorët kërkojnë ndriçim brenda pishave, kërkojmë kontrolla nga policia, sepse po merren edhe substanca narkotike. Drejtorit të Infrastrukturës, në rrugën 'Tahir Zemaj', pse nuk po ndërmerret asgjë për rregullimin e kësaj rruge? Qytetarët prej kopshtit të shtetit, i cili është, duhet të shkojnë deri tek shkolla 'Mihal Grameno' për ta kaluar rrugën. Çdo 100 m duhet të ketë vendkalim për këmbësorë. Ne jemi në komunën tonë dhe duhet të bëjmë kërkesë që të gjejmë zgjidhje.

Jetmir Berisha: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Kam një kërkesë të cilën e kemi adresuar më 04.05.2023, ku ju kemi drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës për pjesën e rrugës Bardh i Madh - Graboc i Poshtëm; rruga e cila është e shkatërruar dhe e demoluar. Desha të pyes Drejtorin, a ka marrë ndonjë përgjigje prej Ministrisë dhe deri ku ka arritur? Kam bërë kërkesë që të paktën ato gropa të mbyllen, unë përsëri do t'i drejtohem Ministrisë pasi që është kompetencë e Ministrisë. Projekti për Graboc të Poshtëm, a keni kontaktuar dhe deri ku ka arritur dhe kur do të

realizohet projekti i ujësjiellësit? Në rrugën 'Gjon Buzuku', Bardh i Vogël, që ka mbetur një pjesë pa asfaltuar, pse nuk është përfunduar dhe kur do të përfundohet, sepse banorët kanë vështirësi.

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Po filloj me problemin e rrugës Lumi në fshatin Miradi e Epërme, në të cilën nuk po ndodhë asgjë. Drejtorit të Inspektoriatit i urojm suksese në punën e re, ki shumë punë vetëm se di sa të lejohet, nëse ki nevojë për ne, jemi të gatshëm të ju ndihmojm. Pikërisht në rrugën Miradi e Epërme, është duke u zhvilluar një veprimtari e mbetjeve inerte që hudhen atje, kan tentu me disa pëlqime për me operuar në atë pjesë, por nëse je i interesuar mundesh me shikur në atë pjesë dhe te paktën me u interesua. Problemin që e kemi ngrit më herët në zonën industriale, në Miradi të Epërme, është një operator ekonomik i cili ka vendos pengesa në rrugë, të cilat janë në kundërshtim me rregullat e komunikacionit me një gjatësi prej 50 metrave, janë të vendosura pesë pengesa, po shkakton vështirësi për banorët. Rregullorja për varrezat, ne këtë shqetësim e kemi ngrit edhe në mbledhjet e kaluara, rregulloret bëhen për me lehtësuar punën, por nuk po implementohet po shkelet ligji. Drejtoria e Arsimit, jemi duke marrur ankesa prej disa prindërve, nëpër disa shkolla, ku ka mësimdhënësit të cilët nuk po e respektojnë orarin e shkollës, shkojnë në shkolla dhe i angazhojnë nxënësit që mbajnë mësim, këty po humbin shumë fëmijët, ju lutem merruni me këtë çështje ose angazhoheni Inspektoriatin e Shkollave.

Laureta Gojnovci: Kolegu z. Vlonjat doli me një fjalim me një ironi nga asambleistët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke iu drejtuar me pyetjen si ndiheni kur parashtroni pyetje, në kuadër të asaj që kinse nuk dalin me bë pyetje, më së miri e dinë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, e dinë drejtorët Kryetari dhe Nënkrjetari i Komunës angazhimin e secilit asambleistë të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komunën e Fushë-Kosovës, mos prisni nga as një anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me dal në foltore dhe me i fyer kolegët e Kuvendit të Komunës, po ashtu anëtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk dalin me fole fjalë jo të hijëshme ashtu siç ka folur kolegu im në Komitetin për Politikë dhe Financa, i cili i ka ngatërruar dokumentet kryesore të Komunës duke e ngatërruar Raportin e shpenzimeve të vitit 2024 me Buxhetin e vitit 2023.

Vlonjat Hasani: Kolegu z. Laureat, ka hasur në keqkuptime, unë thash po më vjen mirë që kolegët kanë filluar me dal me bërë pyetje, unë i inkurajova. Kjo formë e reagimit të juaj len me kuptuar që ju nuk jeni mësuar me parashtruar pyetje dhe për ata reaguat. Sa i përket Komitetit për Politikë dhe Financa, është një procesverbal i cili mbahet dhe mundemi me shikuar.

Fisnik Sllamniku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Po filloj me Drejtorin e Arsimit, licencimi ka filluar dhe pyes a janë bërë grupe punuese në nivel të Drejtorisë së Arsimit dhe me dhënë rekomandime që secilës shkollë i takon sepse janë udhëzimet për fillimin e licencimit, ku ka afat deri në vitin 2027. Kam një kërkesë nga shkolla 'Vëllezërit Frashëri', me tri paralele ku jemi shkolla më e madhe prej të gjitha fshatrave me numër të nxënësve dhe kemi kërkuar që në për tri paralelet të jetë një psikolog dhe nuk e kemi, kjo është kërkesë e shkollës për arsye të ndryshme. Kisha dashur që këto pyetje, një qendër e cila po hapët në Graçanicë, nga Shoqata 'Bereqeti', a'keni ndonjë bashkëpunim. Ekipi për parandalim dhe braktisje, mungesat e nxënësve, ligji thotë që cikli prej 0-9 është obligativ, këto ligje udhëzime të cilat i kemi nuk janë duke bërë zgjidhje dhe mungesat e nxënësve janë duke u rritur çdo herë, unë mendoj që me bërë një grup punues dhe me filluar me i trajtuar dhe me pasur efekt. Për Drejtorinë e Kulturës dua ta

parashtroj një pyetje për sallat, ku dritaret vetëm një shtresore dhe po thyhen lehtë nga nxënësit, ky është një problem. Në rrugën e fshatit Henc, po mbushet ujë, ka shumë kërkesa edhe pse e dim se është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, por pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike, se a mundet me u hap një kanal i vogël, me dal ujë nga hekurudha, sepse ka shumë kërkesa.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kam një pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, meqë po lidhet me rregulloren ku znj. Aida Alimi ma parashtroj një pyetje, është mirë me ju drejtuar Kuvendit jo Kryesuesit, sepse nga asambleistët kemi kryesues të atyre rregulloreve, kemi shpenzuar para dhe kanë kaluar në lexim të parë, por ekzekutivi nuk i ka pruar në Kuvend, ne punën tonë e kemi përfunduar. Për Drejtorin e Urbanizmit, ne e kemi punuar një rregullore të cilën Ministria na ka kthyer si të kundërligjshme, sa i përket bonuseve, pyetja ime është a mundeni me na informuar ju, sa bonuse i ka dhënë Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës në raport me ju, ndërtuesve të Fushë-Kosovës, sepse ai është duke i nënshkruar vet, sepse ka informata nga jashtë. Herën e kaluar kam parashtuar pyetje për laboratorët dhe nuk kam marrë përgjigje të saktë, unë kam shkuar derë me derë sa laboratorë të fizik kemi. I lus të gjithë asambleistët që unë jam i gatshëm me ju mbështet për të gjitha ato shkeljet të cilat i paraqit, mos u ndalin, sepse nëse ndaleni këto mbesin këtu.

Drejtori për Arsim: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Po filloj me përgjigjen për pyetjen që e parashtroi kolegu z. Mirsad Qyqalla. Sipas rregullores, çdo operator që hap gropat është i obliguar t'i kthejë ato në formën e mëparshme dhe për këtë Drejtoria e Shërbimeve Publike është kompetente. Po ashtu, pyetjen që e parashtroi z. Shpend Bardiqi, të cilën e ka ngritur edhe Kryesuesi i Kuvendit në mbledhjen e kaluar, sa i përket laboratorëve, e kam thënë edhe herën e kaluar, se kabinetet e Fizikës, Kimisë dhe Biologjisë, dhe i kemi shpërndarë në faqen zyrtare të Drejtorisë së Arsimit, ku nxënësit e shkollës 'Daut Bogujevci' mund të shohin qartë se çfarë shkolle është shkolla 'Daut Bogujevci'. Pasi kabinetet e Fizikës, Kimisë dhe Biologjisë i kemi në shkollën 'Mihal Grameno', 'Selman Riza', në gjimnaz, ku është një profesor. Unë ju ftoj të shkoni dhe të shihni se çfarë bëjnë nxënësit në Komunën e Fushë-Kosovës, në ato kabinete që i kemi. Kemi shumë paragjykime sa i përket punës që bëhet nëpër shkolla. Kabinetet i kemi në Graboc të Poshtëm, në Sllatinë të Madhe, në Bardh të Madh, në shkollën 'Daut Bogujevci', në shkollën 'Hoxhë Kadri Prishtina' dhe në shkollën 'Minatori'. Dua t'ia jap si informatë z. Shpend Bardiqit, se dy nxënës nga Komuna e Fushë-Kosovës, nga dy shkolla të Komunës së Fushë-Kosovës, në garën e Gjuhës Shqipe, sot ka ardhur informata nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku ata e përfaqësojnë Kosovën, mes Shqipërisë dhe Kosovës. Tri ditë më parë, në gara rajonale, shkolla 'Daut Bogujevci' zuri vendin e parë në garat e volejbollit dhe e përfaqëson Komunën e Fushë-Kosovës në nivel vendi. Dua t'i përgjigjem znj. Dardane Sogojeva, se transporti i nxënësve të Bardhit të Vogël, Harilaçit, komisioni e ka filluar punën, janë më shumë se 950 aplikues dhe besoj se deri në fund të javës së ardhshme, komisioni do ta përfundoj punën e tij, sepse vërtetë kemi vonesa. Shkolla në Pomozotin, e braktisur, është e vërtetë unë kam intervenuar në bashkëpunim me policinë dhe së bashku me punëtorët e Shërbimeve Publike, ku aty kemi pasur disa shkrime të ndryshme të pahijshme dhe i kemi fshirë, nëse nuk gaboj. Kuvendi ka marrë një vendim për të kaluar në Arkiv, por përfundimisht nuk e di se çka ka ndodhë. Subvencionet për bursa janë mbi 950 aplikues. Besoj se deri në fund të javës do t'i

përfundojmë dhe do t'i postojmë në ueb-faqën e komunës. Për z. Vlonjat Hasani, sa i përket mosrespektimit të orarit nga mësimdhënësit, brenda muajit unë do të zhvilloj procedurën për vendosjen e skanerëve nëpër shkolla për hyrje-dalje. Sa i përket mungesave të mësimdhënësve në baza mujore, unë, me rekomandim të shkollave, marrë masa ndëshkuese dhe ua heqim mëditjet atyre mësimdhënësve që nuk janë në proces mësimorë pa arsye. Unë kam dy punëtorë që dalin kohë pas kohe dhe vëzhgojnë. Sa i përket pyetjes që e parashtroi z. Fisnik Silamniku, është shumë e rëndësishme dhe ka të bëjë me licencimin e mësimdhënësve. Ministria e Arsimit ka hapur thirrjen publike për licencim, duke pasur parasysh mungesën e mjeteve financiare, në paga dhe mëditje, nuk na lejohet të formojmë grupe punuese, por drejtorët e shkollave e kanë për obligim ligjor t'ua japin vërtetimin të nënshkruar. Pastaj mësimdhënësi përmes platformës e-Kosova aplikon. Në shkollën 'Vëllezërit Frashëri', ka mungesë të psikologes, është e vërtetë, por në atë shkollë që ne e identifikojmë si problem kyç dhe prezenca e psikologes duhet të jetë patjetër, atëherë ne i marrim psikologët tjerë dhe i angazhojmë nëpër shkolla. Po ashtu, ju bëj thirrje secilit asambleist që Qendrën për fëmijë me nevoja të veçanta, në qendër të Prishtinës, ekziston vetëm një qendër për fëmijët me nevoja të veçanta dhe me të vërtetë fëmijët me nevoja të veçanta, kërkojnë kujdes të veçantë. Këtë kujdes nuk po mundemi ta ofrojmë. Prandaj, të bëhemi së bashku dhe ta bëjmë kërkesën që ta ndërtojmë një objekt, sepse me të vërtetë është i domosdoshëm, për të ardhmen e tyre. Aktualisht, ne detyrohemi që këta fëmijë t'i mbajmë nëpër shkolla. Ekipi për Parandalim dhe Braktisje, ekipi është i formuar në kuadër të shkollave dhe vepron sipas nevojave të cilat arrijnë nga shkollat. Ligji për braktisje është në fuqi dhe nuk mundemi të punojmë ndryshe, edhe pse ka mangësi, por ne jemi të obliguar t'i respektojmë ligjet në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë kam me t'i dorëzuar fotografit dhe ka me t'i dëshmuar, se atë që e thatë ju, pjesërisht nuk qëndron fare, por mbetet të shohim.

Shpend Bardiqi: Çfarë laboratorësh ekzistojnë? A janë aktive këto që i cekët?

Drejtori i Arsimit: z. Shpend Bardiqi, laboratori i informatikës nuk ekziston, kabinet po, mund të shkojmë së bashku dhe t'i shikojmë. Nuk ka rregullore për bursa, ka rregullore për subvencionimin e vitit 2013, ndërsa niveli qendror e rregullon 'Shpërndarjen e Subvencioneve për Organizatat Jo Qeveritare.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Po filloj me z. Mirsad Qyqalla, për mbjelljen e drunjve, është gjithçka brenda afatit. Ka qenë sezoni i dimrit dhe për këtë arsye, jemi duke vazhduar ende. Po ashtu, edhe në rrethojat metalike, përafërsisht kanë mbetur edhe 90 drunj për t'u mbjellë dhe besoj që shumë shpejt do të përfundojnë. Pse janë shkurtuar drunjtë, e kemi bërë për arsye të estetikës. Ndërsa rrethojat në projektim janë ndarë sipas rrezikshmërisë. Por, kur e kemi parë gjendjen në terren, e kemi konstatuar që ka mundësi të bëhen të gjitha, sepse e kemi pas mundësinë dhe besoj që ka dalë bukur. Diku janë 1.25, diku ku ka pllaka metalike janë 1.50 rrethojat, sepse ato hynë ndër dhe, pastaj saldohen. Sa i përket rregullores së varrezave, nuk më përket mua, sepse unë nuk vendos për marrëveshjet komunë dhe Bashkësi fetare, ne vetëm i zbatojmë. Këto marrëveshje janë publike dhe i merr Kryetari i Komunës së bashku me Bashkësinë Islame, ku bëhet subvencionimi. Në Bardh të Madh rruga UÇK-së, Udhë e Shehrit, nuk punon ndriçimi! Është e vërtetë, sot del

kompania dhe e rregullon. Në mbledhjen e kaluar, z. Hasan Ismajli ka bërë pyetje për një ngastër që është me qera, unë ju informoj se nuk ka leje nga Drejtoria e Shërbimeve Publike. Dua t'i përgjigjem z. Migjen Kolshi, për linjat e autobusëve, ku edhe sot ka ndodhur një problem dhe jam njoftuar me kohë, që operatori i linjës Harilaç nuk është duke funksionuar. Arsyeja e këtij mosfunksionimi është në shenjë proteste, sepse Prishtina i ka subvencionuar linjat e autobusëve, ndërsa ne ende nuk kemi arritur ta bëjmë, sepse një grup punues është duke punuar për rregullimin e linjave, pastaj do të subvencionohen. Jemi duke punuar dhe besoj që shumë shpejt do të dalim me një përfundim. Ndriçimi publik, i nderuari z. Migjen Kolshi, po më vjen shumë keq sepse kjo nuk është tendencioze për asnjë fshat, por fatmirësisht që një vit prej kur e kam pranuar detyrën, ndriçimi është duke funksionuar shumë mirë. Unë e kam një kontratë për mirëmbajtje, të cilën e kam lënë për raste urgjente kur po bien linjat dhe për këtë arsye nuk po mundem një herë të ndërhyjmë në vendet e tjera. Unë i kam dorëzuar të gjitha dokumentacionet në prokurim dhe në momentin që ta marrim kontratën e re, do të fillojmë nga: Henci, Harilaçi, Bardhi i Vogël. Jemi duke punuar dhe nuk e kemi anashkaluar. Ujësjetllësit ne i kemi lënë gati dhe i kemi thënë studios projektuese që të kemi dy mundësi, sepse ne nuk e dimë nëse ka sasi ujësjetllësi për të lidhur edhe fshatin Harilaç. Studios projektuese i kemi thënë që ta bëjnë edhe me rezervuar. Studio projektuese është duke punuar, matjet në terren i ka bërë. Kjo gjë është në koordinim me ujësjetllësin. Afati ka qenë në fund të muajit prill dhe besoj që këtë verë do të përfundojë dhe do të ketë edhe rezervuar të ri. Pyetjen tjetër e kisha për rrugën 'Amir Elmazi'. Problemi që ka ndodhur me këtë rrugë është kur ka qenë dikush tjetër Drejtor i Urbanizmit, sepse buxheti ka qenë me urbanizëm. Kjo pyetje për mbylljen e rrugës është për Drejtorin e Urbanizmit. Që një vit kur jam unë Drejtor i Shërbimeve Publike, nuk kam lëshuar asnjë pëlqim për hapësirat publike. Për arsye të bizneseve, të vetmin pëlqim që e kam lëshuar është për mundësinë e shkarkimit të mallrave për bizneset për t'u furnizuar. Nëse inspektimi vazhdon me këto punë të mira, do t'ia dalim këtij problemi. Znj. Aida Alimi ka bërë një pyetje lidhur me ndriçimin te lapidari i dëshmorit 'Naser Sekiraça'. Këtu kemi një problem me furnizimin, duhet të hapet një kanal dhe me kontratën e vjetër nuk kemi mundur ta realizojmë. Tani, me kontratën e re, besoj se do të rregullohet. Sa i përket kabllove elektrike ajrore, ju kam shkruar që në marrjen e detyrës, por nuk kam marrë përgjigje nga drejtori i KEDS-it. Sa i përket qenve endacakë, kontrata është në fazë prokurimi. Është një problem rajonal. Në momentin që ta marrim kontratën, do të dalim në terren. Rruga 'Tahir Zemaj' - vitin e kaluar kemi intervenuar në rreth 500 metra, përmes kontratës për riparim të rrugëve. Tani jemi duke pritur kontratën e re, pasi duhet të riparohet për arsye të kanalizimit që është realizuar. Rrethojat në rrugën 'Nëna Terezë' janë vendosur për arsye se nuk kemi mundur të ndikojmë në uljen e shpejtësisë, pasi kjo është në kompetencë të ministrisë. Unë mendoj se ka pasur sukses, sepse më parë ka pasur edhe raste incidentesh. Pyetja e z. Jetmir Berisha për rrugën në fshatin Graboc të Poshtëm - ministria nuk po merret me këto rrugë, sepse është përgjegjëse edhe për mirëmbajtje, edhe për ndriçim, pasi bëhet fjalë për rrugë rajonale. Ne nuk kemi marrë përgjigje asnjëherë, edhe pse ua kemi adresuar disa herë. Ujësjetllësi në fshatin Graboc të Poshtëm - as ujësjetllësi për projekte nuk është duke bashkëpunuar me ne dhe nuk kam asnjë informacion, as për Graboc, as për Sllatinë. I nderuar z. Fisnik Sllamniku, është në kompetencë të ministrisë largimi i ujit, por në momentin

që të më jepet mundësia, do ta rregulloj një herë përfundimisht. Kemi intervenuar disa herë, por problemi mbetet i njëjtë. Znj. Dardane Sogojeva, kemi diskutuar për ndriçimin, por për arsye të rrezikut nga zjarri, nuk mundemi.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Përshëndetje për të gjithë në mbledhje. Mua më janë adresuar dy pyetje nga z. Mirsad Qyqalla, lidhur me çështjen e sallave në Komunën e Fushë-Kosovës. Pas përfundimit të renovimit të tyre, ju siguroj se unë, së bashku me ekipin tim, kemi dalë në terren dhe megjithëse nuk kam arritur t'i monitoroj të gjitha, ju siguroj se pas përfundimit do të përgatis një raport që do ta keni edhe ju, me të gjitha punët e përfunduara. Kjo është përgjigjja ime për çështjen e sallave. Sa i përket shtrimit të një iftari, ju siguroj se vetëm 9 persona kanë qenë prezentë. Të tjerët kanë qenë familjarë të tyre dhe unë, në takimet e rregullta që kemi mbajtur me Komisionin për shënimin e përvjetorit të masakrës së luftës në Komunën e Fushë-Kosovës, kemi pasur si propozim që të shtrojmë një darkë për familjarët e personave të vrarë gjatë luftës në Fushë-Kosovë. Unë e kam marrë përsipër këtë organizim dhe nuk kam pasur asnjë tendencë tjetër. Jam munduar që edhe juve t'ju përfshijë. I nderuar z. Fisnik Sllamniku, sa i përket dritareve të vendosura, ajo është në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit. Pyetjen tjetër e kam pasur nga z. Hasan Ismajli, i cili pyeti: "Sa dëshmorë ka Komuna e Fushë-Kosovës?" Unë kam trashëguar një listë ku janë të evidentuar dëshmorët e Komunës së Fushë-Kosovës. Këtë listë e kam në zyrë dhe mundem t'ua jap. Ajo listë është që 25 vjet dhe ne vazhdojmë të shërbehemi me të. Nesër kam një takim dhe do ta parashtoj këtë pyetje për arsye sigurie.

Hasan Ismajli: Dëshmor i kombit, i certifikuar nga shteti, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është edhe vëllai im, i rënë në vitin 1988. Po ashtu, një Krasniqi në vitin 1989, së bashku me Shukrije Obërtincën, e cila u vra në vitin 1989, te Xhamia e Llapit. Po ashtu është edhe Daut Pillana, nga fshati Bardh i Madh. Viktimat e para janë këta tre, të cilët kanë ardhur me arkivole të blinduara. Në atë iftar që e keni shtruar, nuk ka qenë asnjë familjar i imi i ftuar. Të inkurajoj për punën, por mos i ndaj.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Komisioni i cili është formuar nga familjarët dhe të cilin unë e kam kryesuar, e kam trajtuar edhe këtë çështje - dhe ke qenë dëshmitar për këtë. Kërkesa ime ka qenë: a t'i përfshijmë edhe këto familje, duke përfshirë edhe vëllain tënd dhe të ndjerin z. Afrimin, për të cilin kam qenë prezent edhe kur është vrarë, edhe në varrimin e tij në atë kohë. Ata më kanë thënë se mund të jenë pjesë e Ditës së Çlirimit, por jo në shënimin e përvjetorit të masakrës së Fushë-Kosovës.

Drejtori i Kadastrit dhe Gjeodezisë: Pata disa pyetje nga asambleistët për ngastrën 1375. Unë e kam sqaruar një herë, por dua ta sqaroj përsëri. Bazë kryesore ligjore për pronësinë është fleta poseduese. Ngastra 1375-0, në fletën poseduese, nuk ka pasur ndryshime asnjëherë. Prona i ka 27 ari, i ka pasur dhe 27 dhe tani i ka. Pjesa grafike, e cila ka qenë e ndarë, është pjesë që është trashëguar më herët. Për qëllime planifikimi dhe zbatimin e planit zhvillimor komunal të ri, kjo ngastër është kthyer në gjendjen fillestare dhe është në përputhje të plotë me fletën poseduese. Sa i përket propozimit që e ngritët për ndarjen e ngastrës për xhami, propozimi ka ardhur për ngastrën me Nr. 1375-0, 18 ari. Fleta poseduese, në momentin që është kthyer, ka pasur 27 ari dhe i ka pasur edhe tani. Kjo tregon se pjesa e ngastrës komunale nuk është prekur dhe janë ato metra që i ka pasur, sepse Agjencia Kadastrale ka pasur 27 ari dhe tani i ka 27. Fleta poseduese nuk është prekur asnjëherë. Po ashtu, edhe nga Agjencia Kadastrale e keni përgjigjen, ku nuk është prekur asnjëherë. Unë jam duke diskutuar pjesën ligjore, jo grafike. Po flas për dokumentin kryesor, i cili është baza kryesore dhe ka 27 ari dhe nuk është prekur asnjëherë. Fleta poseduese shkruan titullarin dhe me të shkon edhe tek noteri. Në sistemin ku punojnë punëtorët, çdo njëri lë gjurmë aty.

Drejtori i Inspektoriatit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Së pari, dua t'ju falënderoj për urimet që më dërguat mua. Inspektorët janë çdo ditë në terren, duke evidentuar problemet që janë në qytet. Për të gjitha ankesat dhe kërkesat e juaja, do të reagojmë dhe do të mundohemi maksimalisht ta zbatojmë ligjin. Kontratën për rrënim momentalisht e kemi në prokurim; deri më datën 17 do të hapet dhe do të mundohemi të fillojmë me lirim e hapësirave publike, që është gjithashtu një plan im.

Drejtori i Urbanizmit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Sa i përket çështjes së ngastrës së xhamisë, besoj se tash, pas sqarimeve që dha Drejtori i Gjeodezisë, nuk po di si ta trajtoj më tej si pyetje, sepse pyetja ka qenë: 'A lëshoni leje ndërtimore?' dhe kam përgjigjur 'Po', sepse kërkesë zyrtare për pajisjen me kushte ndërtimore unë nuk kam pasur. Edhe atëherë kam deklaruar se është vetëm një inicim i procedurës. Për ta dhënë në shfrytëzim, ajo ngastër ka qenë me titullar Komuna e Fushë-Kosovës dhe unë nuk jam marrë me analizat e asaj që është mospërputhje mes fletës poseduese dhe kopjes së planit. Përndryshe, vazhdimisht, gjatë procedurave për pajisjen me leje ndërtimore ka diskrepancë midis asaj që shkruan në fletën poseduese dhe kopjes së planit. Pak më shumë me këtë çështje është marrë z. Hasan Ismajli dhe ky mund të konfirmojë se ka raste të tilla, kur një bllok ndërtues që bashkon disa ngastra, mund të dalë me një sipërfaqe një hektar, ku gjendja grafike tregon 96 ari, ndërsa kur bëhet situacioni gjeodezik, gjeodeti e konfirmon se sipërfaqja në terren nuk është ajo që është e përshkruar. Me fletën poseduese, vjen edhe personi për të vazhduar fletën poseduese, por të gjitha këto vërtetohen me situacion gjeodezik, sipas matjeve gjeodezike në terren. Kjo është, sepse edhe matjet gjatë viteve '70-ta' kanë pasur tolerancë të madhe gabimesh dhe janë rivlerësuar me Kosova - red. Kam pasur pyetjen e znj. Dardane Sogojeva për ndërtimet pa leje. Në një raport thuhet se 75% e ndërtimeve në Kosovë janë pa leje. Këtu hyn kategoria e parë, por mund të përfshihen edhe ndërtimet shumëbanesore. Vitin e kaluar ka qenë një numër prej 1700 objekteve të legalizuara, ndërsa 350000 janë pa leje. Kjo është një përllogaritje e përgjithshme, sepse informata zyrtare nuk kemi, por këtë mund ta sigurojë Geoportali. Në Fushë-Kosovë, unë kam raportin prej 2020 ku janë pajisur 13 subjekte afariste; ata kanë interes. Në vitin 2021 janë pajisur 25, në vitin 2022 janë pajisur 12, në vitin 2023 janë pajisur 15 dhe në vitin 2024 janë pajisur 18. Në bazë të kësaj, mund të argumentojmë sa është numri i lejeve që lëshohen çdo vit: 2021 - 59 leje, në kategorinë e parë dhe të dytë, 2022 - 49 leje, 2023 - 46 leje dhe 2024 - 50 leje, ku në vit janë lëshuar përafërsisht 50 leje. Inkasimi në euro: 2,200,000.00€, 1,200,000.00€, 910,000.00€ dhe në vitin e kaluar 1,200,000.00€, kemi rënie në sipërfaqen ndërtimore të kategorisë së dytë, sepse aty bëhet edhe inkasimi më i madh me financa. Pyetja tjetër e kam prej Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, në lidhje me Rregulloren e bonuseve të zonimit dhe çështjen e shpronësimit. Jemi duke punuar me një vendim të Kryetarit të Komunës, ku janë shpronësuar ngastrat me interes të përgjithshëm dhe ngastrat për infrastrukturë rrugore. Nuk kam informacion të saktë për sipërfaqet që janë shpronësuar me metra katror, por përveç projekteve infrastrukturore dhe hapjes së rrugëve të reja të planifikuara, mund të përmend vetëm si sipërfaqe: shkolla fillore tek 'Al Trade', 20 ari; shkolla tek 'Amir Elmazi', 18.5 ari; shkolla tek 'Fazli Grajçevci', 24 ari fazën e parë dhe faza e dytë me 16 ari përafërsisht. Pritet të shpronësohet kopshti që ka qenë në procedurë prokurimi dhe tani është në Organin Shqyrtues të Prokurimit, është 20 ari shpronësim. Qendra e Mjekësisë Familjare tek rruga 'Fazli Grajçevci', 20 ari; kopshti tek kompleksi 'Orienti', 20 ari; po ashtu edhe disa prona të tjera me 7 ari dhe 10 ari, për ndërtimin e kopshteve. Nëse ju intereson të dini vlerën financiare të përfitimit të komunës nga pronat private që kanë kaluar në pronë publike, mund të llogaritet se komuna ka pasur fitim rreth 5,000,000.00€, pa i llogaritur edhe investimet që dalin aty dhe që do ta shumëfishojnë vlerën e përfitimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderoj secilin drejtor për përgjigjet e dhëna.

Koha e pushimit në kohëzgjatje prej një ore.

Pika e tretë (3) - Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Komunës për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Komunës për vitin 2024'. Hap diskutimin.

Mirsad Qyqalla: Unë dua të flas, vetëm sa për të mbetur në procesverbal, sepse nëse vjen 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Komunës për vitin 2024' dhe nuk është askush prezent nga ekzekutivi, përveç Drejtorit të Gjeodezisë dhe Kadastrit, jeni duke e injoruar Kuvendin. Është mirë edhe ne të anashkalohe mi nga diskutimi, edhe pse e kemi shfletuar, por drejtorët nuk janë prezentë, sepse ka shumë çështje të paqarta në atë raport dhe nuk keni kujt t'i drejtoheni.

Hasan Ismajli: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, në 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Komunës për vitin 2024', nuk ka vlerë as të diskutohet, sepse Kryetari prej ditës kur e ka dhënë betimin, asnjëherë nuk ka qenë më në këtë sallë dhe as sot Nënkryetari nuk ka ardhur. Janë plotësisht të anashkaluar dhe nuk dua të merrem më me të.

Vlonjat Hasani: Tani 'Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Komunës për vitin 2024', do të kishte qenë mirë që këtë raport ta quanim 'Raporti i Mospunës së Kryetarit të Komunës'. Po ashtu, edhe disa drejtorë, asnjëherë nuk e kanë respektuar Kuvendin nga Kryetari i Komunës dhe ai që nuk është i respektuar, nuk të respekton. Brenda raportit kemi parë disa të dhëna jo të sakta, edhe pse jam shumë i sigurt që këto ai nuk i ka shkruar vetë, por të tjerët janë munduar të arsyetojnë, jemi mësuar me ta. Ky Kryetar vetëm punë nuk bën, transparenca është zero, ata nuk mendojnë për personat që kanë nevojë, sepse për veten kanë bërë zgjidhje. Këto shifra dhe këta numra nuk janë të vërteta, shpresojmë që do të jetë raporti i fundit i Kryetarit të Komunës.

Pika e katërt (4) - Informatë për shpenzimin e buxhetit të komunës për vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E nderuara znj. Merita Krasniqi, ju ftoj, nëse doni ta merrni fjalën, materialin e keni marrë edhe shtojcën e materialit, nëse keni mundësi ta paraqisni në vijat kryesore.

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: Përshëndetje për të gjithë në mbledhje. Informata financiare është përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kontabilitetin e parës së gatshme. Komuna e Fushë-Kosovës nuk operon në llogarinë e vetme bankare, qeveria, thesari i administron llogaritë e të gjitha komunave. Buxheti janar-dhjetor për vitin 2024 ka arritur në total prej: 23,880,871.83€. Raporti i ekzekutimit të buxhetit: nga buxheti i alokuar janë shpenzuar 20,840,000.00€ ose 87.2% e buxhetit, duke u nisur nga granti i përgjithshëm qeveritar, që janë alokuar 13,794,850.00€. Nga kjo shumë janë shpenzuar 99% ose 13,663,000.00€. Nga mjetet e bartura janë 6,318,133.88€, të shpenzuara janë 4,365,000.00€, nga donacionet dhe participimet 53,315.11€, janë shpenzuar 80%. Buxheti në total janar-dhjetor për vitin 2024 është 23,880,871.83€ ose 87.2%. Alokimi nga të hyrat e grantit qeveritar është 57.96% të mjeteve financiare, alokimet nga të hyrat vetjake 15.27%, alokimi nga mjetet e bartura 26.55% dhe të hyrat nga donacionet 0.22%. Struktura e pranimeve të alokimeve periodike nga granti qeveritar është: paga dhe mëditje 9,209,930.84€, mallra dhe shërbime 2,160,325.00€, shërbime komunale 350,000.00€ dhe shpenzime kapitale 2,074,560.00€. Të hyrat vetjake periodike për vitin

2024, përveç grantëve të marrë nga niveli qendror për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, komuna ka inkasuar edhe të hyra vetjake komunale kryesore, si: tatimi në pronë, taksat, lejet ndërtimore, shërbimet kadastrale, dënimet e trafikut nga policia, gjobat e trafikut nga gjykatat. Të hyrat totale vetjake të grumbulluara janar/dhjetor 2024 kanë arritur në shumën prej: 5,169,690.30€, që përbën 108.40% të planifikimit të të hyrave për vitin 2024, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2023, kemi realizim 122.42%. Të hyrat vetjake janë: 4,026,062.30€, dënimet e trafikut - policia 1,068,878.00€, gjobat e trafikut - gjykata 74,750.00€. Totali i grumbullimit të të hyrave është në shumën e mjeteve financiare prej: 5,269,690.30€, grant i brendshëm 1,156.50€, donacioni i jashtëm 1,000.00€ dhe totali me grant të brendshëm dhe të jashtëm është 5,171,846.80€. Periudha janar/dhjetor karakterizohet me një realizim të të hyrave në total 5,169,690.30€, apo 108.40% në raport me planifikimin, kurse me dënimet e trafikut dhe gjykatave realizimi është 139.23%, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2023, kemi realizuar 122.42%. Siç shihet nga tabela Drejtoritë që kanë realizuar shumën më të madhe të hyrave në total për periudhën janar/dhjetor janë: Urbanizmi 34.41%, Tatimi në Pronë 29.31%, Kadastër 3.98%, Bujqësi 3.35%, Buxhet dhe Financa 3.20%, Arsimi 0.47%, Shëndetësia 0.80%, Administrata 0.90%, Inspeksioni 0.19%, Donacionet 0.04%, Buxhet dhe Financa 3.20%, Kulturë 0.00%, Arsimi 0.03%. Buxheti periodik është 23,880,871.83€, struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike është: Pagat 100%, Mallra dhe shërbime 96%, Shpenzime Komunale 100%, Subvencione 98% dhe Shpenzime Kapitale 73%. Tek pagat dhe mëditjet për vendime gjyqësore janë shpenzuar 15.83%, mallra dhe shërbime për vendime gjyqësore janë shpenzuar 6.30%, shpenzimet komunale për vendime gjyqësore janë shpenzuar 2.54%, subvencionet për vendime gjyqësore janë shpenzuar 3.05% dhe shpenzimet kapitale për vendime gjyqësore janë shpenzuar 22.30%. Sa i përket fondeve të financimit dhe shpenzimeve buxhetore për kapitalet 2024, nga granti qeveritar janë alokuar 2,074,560.00€, ndërsa janë shpenzuar 2,011,783.17€. Të hyrat 2,510,000.00€, janë shpenzuar 1,542,396.77€, ndërsa të hyrat e bartura 5,849,491.61€ janë shpenzuar 4,028,395.29€. Totali nga fondet e financimit dhe shpenzimeve buxhetore për kapitalet 2024 është gjithsej 10,435,051.61€.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dua një sqarim. Në ora 08:51 minuta, printova një faqe në ueb-faqen ku thuhet se Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, miraton buxhetin për vitin fiskal 2024 në shumën e mjeteve prej: 16,285,500.00€. Kjo figuron në ueb-faqen e Komunës, ndërsa sot e kemi një buxhet të aprovuar prej: 17,509,422.84€. Unë hyra edhe tek buxheti i Kosovës për vitin 2024 dhe aty është shuma e mjeteve prej: 16,215,499.00€. Dua të ma sqaroni pse është shuma e ndryshme. Vërejtjet tjera i kam tek shpenzimet e buxhetit nëpër shkolla, qendra, ujë, kanalizim, të cilat do t'i publikoj në faqen time zyrtare, por unë sot dua të ndalem tek Zyra e Kuvendit. A ka mundësi që ju të merrni para nga Kuvendi dhe me ato para të paguani në drejtoritë tjera? Nëse merrni para nga Zyra e Kuvendit pa dijeninë time si Kryesues i Kuvendit, pa një autorizim, i merrni dhe i dërgoni dikund tjetër, atëherë unë nuk po parashtroj pyetje. Unë nuk mund të pranoj kur shoh tek Zyra e Kuvendit mirëmbajtjen e veturës. Në vitin 2024, kemi pasur një udhëtim zyrtar në Shqipëri, ku më është prishur vetura, e kam dërguar në servis për rregullimin e alternatorit. Unë nuk mund të besoj që një alternator kushton 800.00€. Unë asnjëherë tjetër nuk e kam dërguar veturën më në servis. Këtu figuron 854.00€, që ka kushtuar servisi. Po besoj se ndoshta është ndonjë makinë tjetër, të cilën e keni dërguar në emër të Kuvendit. Kemi shtesa të veçanta për të zgjedhurit, kompensim përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit, 2,638.00€. Ne kemi qenë një herë në Shqipëri dhe kemi shpenzuar shumën e mjeteve financiare prej: 7,000.00€ dhe kemi marrë para xhepi për udhëtim zyrtar jashtë vendit, 4,500.00€. Unë i kam marrë personalisht dhe secili asambleist i ka marrë parat e xhepit. Po ashtu, kemi pasur edhe një shpenzim prej: 7,000.00€. Shuma prej: 2,638.49€ po nuk e kuptoj për çka është shpenzuar?

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: Këto janë reprezentacion.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë e nënshkruaj këtë kontratë me byfen që e kemi këtu, është një kontratë njëvjeçare, 200.00€ në muaj, ku në vit total është 2,400.00€, pyes për të tjerat, ku kanë mbetur?

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: I nderuar, që tri herë radhazi po më pyet për këtë kod?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E nderuar, kërkoj falje, por unë nuk po pyes rusisht, sepse të kam pyetur në Komitetin për Politikë dhe Financa, të kam pyetur edhe personalisht. Tash dua të pyes edhe para Kuvendit të Komunës. Unë po pyes qëllimisht që ta dinë edhe të tjerët, sepse unë asnjë cent lidhur me këtë Kuvend nuk kam marrë, por sa i përket veturës dua ta sqaroni, sepse po më duket që shuma prej: 800.00€ është shumë e madhe.

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: Mundesh me ardhur me e pa lëndën.

Vjollca Konjusha: Përshëndetje për të gjithë. Dua të parashtroj një pyetje për informatën. Asfaltimi në fshatin Lismir, rruga 'Tahir Meha', me siguri u bë ndonjë gabim teknik, sepse rruga 'Tahir Meha' nuk është e shtruar me asfalt, edhe pas shumë kërkesave nga banorët.

Drejtori i Infrastrukturës: Ne e kemi asfaltuar vetëm rrugën unaza, në shumën e mjeteve prej 40,000.00€, ndërsa rrugë të tjera në vitin 2024 në Lismir nuk është asfaltuar asnjë rrugë nga drejtoria ime.

Durim Hajra: Rrugën të cilën nuk po e gjeni ku e keni asfaltuar, po hamendësoj mos është shtrimi i oborreve private. Sa i përket raportit të shpenzimeve, sinqerisht ne po i japim vërejtjet tona, unë këtu mora mundimin të dal më shumë për hir të qytetarëve. Ekzekutivi nuk i merr për bazë vërejtjet tona, këtu kemi të bëjmë me keq planifikim dhe keq menaxhim të parasë dhe mos transparencë, duke filluar nga ky raport. Këtu ka projekte ku as vet zyrtarët nuk e dinë se ku janë shpenzuar mjetet. Edhe Komuna e Fushë-Kosovës, si shumë komuna të tjera, është që dalim prej komunave të tjera, sepse ne e kemi potencialin e të hyrave vetjake më shumë se komunat e tjera. Jemi të varur 58% nga grantet qeveritare. Vitet e fundit kemi kërkesë nga Drejtoritë për Buxhet dhe Financa që, në fund të vitit, të bëhet rritje e buxhetit nga të hyrat vetjake. Si mund të thuash që një drejtori ka planifikuar mirë buxhetin, kur që tri vjet radhazi, afërsisht një milion euro janë huqur në planifikimin e të hyrave vetjake, duke e ditur potencialin? Komuna e Fushë-Kosovës ndoshta qëndron e para sa i përket potencialit, sidomos nga tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit. Pra, kjo e vërteton atë kur flasim për keq planifikim dhe keq menaxhim me paranë publike. Duhet të ndërmarrim veprime konkrete, nëse e kemi gjendjen jo të mirë, me normat në arsim dhe shëndetësi, duhet të shkojmë të interesohemi, pavarësisht se cila ministër është në pushtet. Mbi 6 milion euro, ku është pjesa e bartjes dhe që hyn edhe kjo tek transparenca, por edhe një milion, sa është rritja tek paga dhe mëditjet. Po, është e këtyre kontratave të cilat nuk keni mundur t'i futni në listën e pagave dhe që kanë shkuar përmes përmbarimit, me vendime të gjykatave. Këtu ka pasur nevojë të jetë një raport i veçantë vetëm për këtë. Ne nuk e kemi një listë të punonjësve të cilët paguhen prej këtij buxheti dhe me vendim të këtij Kuvendi. Unë kërkoj një raport të veçantë. Unë çdo herë dyshoj për keqpërdorim të mjeteve të parasë publike. Një element tjetër: nëse nuk na mjaftojnë mjetet për disa investime kapitale, atëherë ka modalitete dhe praktika të ndryshme, ku komunat gjejnë forma dhe burime të tjera të financimit të projekteve. Nëse neve kaq shumë po na dëmtojnë vendimet e gjykatës, po na mbesin edhe projektet kapitale pa i shtyrë përpara, ekzistojnë mundësi të tjera për forma të financimit, qoftë përmes donacioneve ose formave të tjera, të cilat nuk i lënë projektet të zvarriten. Edhe këtu kemi të bëjmë me keq menaxhim. Pyes zyrtaren pse nuk po gjejmë mënyra të tjera të financimit të projekteve? Donacionet janë 0.22%. Unë vet kam qenë dëshmitar

kur janë ofruar organizata jo qeveritare që kanë ofruar donacione dhe i kemi refuzuar. Kur po vjen puna tek ndërtimi, gjithmonë po e gjejmë një gjuhë të përbashkët, për të bërë një marrëveshje, ta quaj partneriteti publiko-privat, në emër të asaj që të krijohet hapësira publike, ku shumë më shumë fiton privati sesa publiku, në ato marrëveshje, ndërsa për projekte të tjera nuk po gjejmë hapësira. Shumë projekte futen si projekte dhe kalojnë nga viti në vit zero. Ndërsa ka projekte që presin dhe që janë kërkesë e banorëve dhe asnjëherë nuk janë përfshirë si projekte. Kur nuk e implementon projektin në kohë dhe nuk ke mjete të mjaftueshme, për t'i paguar vendimet e gjykatave si përmbarimi, atëherë kjo vjen deri në këtë pikë. Nuk po vlerësohen projektet të cilat po planifikohen. Nëse ka aq shumë nevojë, sidomos në pjesën e qytetit, investimi në kanalizimin fekal dhe atmosferik, të paktën të merremi seriozisht me këtë projekt, thuajse gjysma e projekteve kanë mbetur pa u implementuar. Qytetarëve u intereson paraja për t'ju kthyer në investim kapital, shërbime që lehtësojnë jetën e qytetarëve. Drejtoria e Urbanizmit ka shpenzuar 55% të buxhetit, ndërsa Drejtoria e Kulturës ka shpenzuar 75%, nuk e di se çka ka bërë në këtë drejtim. Rritja e shpenzimeve për pagat dhe mëditjet, ne e dimë se janë vendime gjyqësore, por prapë, kjo lidhet me pjesën e keq planifikimit të këtij ekzekutivi, që del se për arsye të vendimeve gjyqësore, janë rritur 188.00% të shpenzimeve në këtë kategori. Bartja e buxhetit, nëse i bartim nga dy-tri vite ashtu siç i kemi bartur ne, është urgjente dhe e domosdoshme që edhe për këtë bartje të kemi një transparencë më të madhe, një raport më të detajuar. Zyra e Kryetarit, për udhëtime jashtë vendit, ka shpenzuar mbi 1,500.00€. Kryetarin e Komunës këtu nuk po e shohim dhe nëse ka dalë jashtë vendit, do të ishte mirë të na kishte prezantuar se për çfarë na ka prezantuar, sepse ai nuk vjen të prezantojë vetën as në Kuvend. Për shërbime të veçanta, konsulentë dhe kontraktorë individualë, 7,300.00€, unë nuk di se çka ka këshilluar dhe paratë më së paku i ka merita ky këshilltar dhe nuk e ka këshilluar, më thënë, 'Shko sot në Kuvend se ke raportin tuaj'. Kujdestaria gjatë natës, punë jashtë orarit të punës, 204.00€, ai punën e vet nuk e përfundon sepse nuk del nga zyra dhe jo këto. Po ashtu, edhe në Drejtorinë e Inspektoriatit, marrin pagat, paguhet plus shtesat, i marrin dhe në terren aspak nuk janë mirë.

Mirsad Qyqalla: Dua ta pyes zyratën tek faqja 10, vendimet gjyqësore, a marrin paraprakisht ndonjë vendim se ku më tërhiqen këto mjete, apo e vendos ministria? Sepse është pak e habitshme që, tek subvencionet, ka vetëm 3.5 që kanë ndërhyrë për vendime gjyqësore, ndërsa tek shpenzimet kapitale ka 36. A vendos ekzekutivi ku t'i tërheqim këto mjete, apo ministria? Sepse prej kësaj që po e shohim këtu, nëse kemi pasur 10 milionë shpenzime kapitale dhe vetëm 7.5 milionë i kemi realizuar, po del që vetëm 50% të shpenzimeve kapitale kemi arritur t'i shpenzojmë. Si është e mundur që në njërën anë po heqim dorë nga shpenzimet kapitale, prej projekteve në emër të gjyqësorit dhe në anën tjetër po realizojmë mbetje prej 3 milionësh? Si është e mundur? Po ashtu, pyes: A ka pasur suficit prej granteve qeveritare dhe a ka ndonjë shifër që ne duhet të kishim pasur si informacion. Sa i përket vendimeve gjyqësore, ne jemi në rregull me një kontratë kolektive, e cila është një problem në nivel vendi, por interesi nga ana jonë është të dimë sa janë vendimet gjyqësore për të cilat jemi gjobitur për fajin tonë, për mospunën tonë, për mosrealizimin e detyrave tona? Sepse ky arsyetim është që të gjitha kanë ndodhur për arsye të kontratës kolektive, por ne e dimë se nuk është ashtu. Kuvendi i Komunës do arsyetim shtesë për të mos pyetur për secilën, sepse ne e dimë se ndoshta me planin kontabël është gjithçka e rregullt. Po filloj nga Zyra e Kryetarit të Komunës, shtesat tranzitore, e cila është e vështirë të kuptohet. Po ashtu, më herët ka pasur shpenzime për derivate të automjeteve, ndërsa tani i kemi bashkuar gjeneratorët dhe makineritë, ku është një shumë e madhe dhe pyetja ime është: A janë këto tash për vetura, apo për

gjeneratorë, apo për makineri? Subvencione për entitete publike, shuma e mjeteve 28 mijë euro, ka shumë të pasqaruara dhe ndoshta më mirë do të ishte një raport më i detajuar. Pyes për Drejtorin e Integritimeve Evropiane dhe Inovacionit, pashë telefonin mobil 1,800.00€, që i bie 150.00€ në muaj dhe ju keni tre punëtorë, kjo është e paqartë. Drejtoria e Inspektoriatit po ashtu ka 112,000.00€, sa shpenzojmë, por shuma është e madhe dhe puna nuk po shihet askund. Qera për automjete më shumë se derivate për terren dhe shumë të tjera që kërkojnë raport më të detajuar. Këto janë taksa tona. Tek Shërbimet Publike, pashë disa shifra të habitshme: rrugë lokale 754,000.00€, parqet dhe hapësirat publike 249,000.00€, po kam dëshirë të di këto ku janë? Infrastrukturë rrugore, rrugë lokale, rregullimi i parkut në Pisha në Sllatinë e Vogël, rregullimi i sheshit në rrugën 'Dardania' dhe shumë të tjera. Më bën përshtypje edhe kontrata për zjarrfikës, furnizim me veshmbathje, ka mos përputhje me atë që po shoh në këto letra. Në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, subvencione e transfere 60,000.00€, a i keni publikuar këto lista? Shërbime Kadastrale, akomodim për udhëtime zyrtare brenda vendit 3,458.00€, kishte qenë mirë të na shpjegoni. Në çdo raport janë disa shpenzime për disa shkolla, ku disa kanë automjete zyrtare, disa jo. Në shkollën 'Bajram Curri' në Sllatinë të madhe, janë 22,000.00€ shpenzime për dru. Në shkollën fillore 'Zenel Salihu' në Bardh të Madh, ishin afër 8,000.00€, më pak se në shkollën 'Bajram Curri'. Këto dy shkolla janë të njohura për nga madhësia, po ashtu edhe orarin e kanë të njëjtë. Shpenzimet për drunjtë në total, nëse i marrim, janë afër 166,000.00€ të prezantuara, ndërsa në kontratë janë 206,000.00€. Po ashtu, ne kishim lidhur një kontratë për dezinfektim dhe dezinfektim, në shumën e mjeteve prej: 37,000.00€, por kontrata është nënshkruar më 19.09.2024. Si u nënshkrua kjo kontratë me vonesë, ndoshta kisha mundur ta kuptoja deri diku, por që të fillonte zbatimin i saj në muajin tetor, për mua është absurde dhe nuk di kujt i ka shërbyer, sepse unë nuk e kam parë asnjëherë. Po ashtu, mirëmbajtja e rrugëve lokale në sezonin veror, në shumën e mjeteve financiare prej: 40,000.00€, nëse ka mundësi, më trego dikush se cila rrugë është mirëmbajtur këtu në Fushë-Kosovë. Pashë edhe ndërtimin e parqeve, në shumën e mjeteve prej: 93,000.00€. Unë dhe kolegu im kemi qenë bashkë kur kemi bërë kërkesë për dy ulëse dhe më keni thënë që nuk ka, ndërsa shpenzimet po figurojnë. Unë nuk kam kërkuar për vete, por për qytetarët. Po ashtu, tek ndriçimi ishte një kontratë prej: 31,000.00€, por nuk po kuptoj, shpenzimet janë dhe gjithmonë janë jashtë funksionit. Këtu ka mungesë të mbikëqyrjes së punëve dhe lë për të dëshiruar.

Hasan Ismajli: Pashë në këtë raport Shtesa të veçanta për të zgjedhurit. Pyes, çfarë shtesa të veçanta kam unë si i zgjedhur i popullit? Telefoni mobil, i nderuar, paske shpenzuar 590.00€. Po ashtu, ne të gjithë kemi vetura dhe e dimë sa kushton kontrolla teknike, sa kushton sigurimi dhe sa kushton regjistrimi. Këtu, një Golf 4 u regjistrua me 343.00€, ndërsa unë kam një Golf 6 dhe me kontroll teknike, me sigurim, del përafërsisht 230.00€. Këtu janë edhe udhëtimet zyrtare. Ne kemi qenë, por e shoh edhe një shtesë këtu, për një udhëtim zyrtar jashtë vendit. Kush ka shkuar në emër të Kuvendit? Po ashtu, kemi shumën e mjeteve financiare prej: 2,638.00€ për shpenzime të bufes. S'po kuptoj, sepse është një shumë e madhe dhe ne realisht kemi 11 muaj mbledhje, sepse një është pushim, ndërsa kontrata mujore është 200.00€. Unë kam folur edhe në mbledhjet e kaluara për derivatet dhe tash dua që t'i them edhe me emra ata të cilët marrin derivate në veturat private: Nënkyetari i Komunës, Drejtori i Financave, Zyrtarja për Komunitete - Sladjana Lazic,

Nënkryetari i Komunës për Komunitete dhe z. Bashkim Krasniqi, i cili çdo muaj merr nga një rezervar. Besoni se ka më shumë se këta, por edhe ata do t'i publikoj emrat e tyre kur t'i vërtetoj. Me cilën rregullore ju takon? Unë kam bërë kërkesë zyrtare, ku kam kërkuar të gjitha veturat brenda oborrit të Komunës, pa qenë autobusët, shëndetësia dhe arsimi, por vetëm zyrtarët komunalë që i shfrytëzojnë, para një viti dhe nuk kam marrë përgjigje. Një pjesë të fajit e kanë edhe kolegët e mi, të cilët nuk i ngrisin këto shqetësime, ndërsa qytetarët i dinë të gjitha dhe për ata keni rënë në vendin e tretë. Nuk mundet dikush të shpenzojë më shumë se 1,000.00€ për një udhëtim zyrtar, sepse nuk ka ftesë zyrtare. Unë kam kërkuar edhe vitin e kaluar kur ka udhëtuar me pasaportë të Republikës së Serbisë dhe me vendbanim në Novi Sad dhe me ato dokumente ka ardhur dhe i ka dorëzuar në Drejtorinë e Financave dhe pagesën e keni përfunduar me një dokument të Republikës së Serbisë dhe banor i Novi Sadit. Këtu hynë shpenzimet e telefonisë, bufes. Nuk janë këto, sepse ju i keni 200.00€ në muaj, ku për 11 muaj janë 2,200.00€, ndërsa këtu po dalin më shumë dhe pyes: Ku shkuan ato? Unë e di se këta i bartin mjetet nga një drejtori në drejtorinë tjetër, sepse kështu i mbulojnë, por unë si asambleist nuk i kuptoj këto bartje, këto kode? Shpenzimi i druve dhe prodhimi i druve dhe shumë e shumë të tjera.

Fisnik Sllamniku: Unë mendoj se kur të kemi pikën e buxhetit, duhet të jetë vetëm kjo pikë dhe asnjë pikë tjetër. Sepse na duhen shumë sqarime nga drejtorët. Unë pashë që u manipuluan me shifra dhe një drejtori i ka shpenzuar 80%, ndërsa tjetri 50%. Për këtë arsye, them se më mirë do të ishte që për secilin të na shpjegojnë si ka shkuar ecuria. Patëm pyetjen pse Golf 4 është më i shtrenjtë. Unë e di se më i shtrenjtë është sigurimi i një Golf 4, sesa i një Golf 7, sepse varen nga kubikazhi i veturës.

Durim Hajra: Unë e kam bërë një krahasim të nënshkrimit të drejtorit të financave nga viti i kaluar dhe tani dhe unë po dyshoj a ka nënshkruar drejtori apo jo. Unë po i drejtohem zyrtarit ligjor për të na sqaruar nëse dikush ka nënshkruar në vend të dikujt tjetër dhe nëse ka të drejtë dikush të nënshkruajë në emër të tjetrit.

Hasan Gjyrevci: Unë nuk jam kompetent për këtë.

Vlonjat Hasani: Regjistrimi i automjeteve, 150.00€ dhe sigurimi i automjeteve 641.00€, këtu diçka nuk është në rregull. Ndoshta na sqarohen dikush. Po ashtu, tek Drejtoria e Inspektoriatit po e shoh, kompjuterët në shumën e mjeteve financiare prej: 20,000,00€, na sqarohen? Asfaltimi në fshatin Miradi e Epërme, rrugët Gjon Buzuku, Flamuri dhe Prizreni, shuma e mjeteve është prej: 40,838,00€. Këtu po duket si një projekt i përfunduar, realizuar, apo jo?

Merita Krasniqi - Udhëheqëse e Sektorit për Financa dhe Buxhet: Lëvizjet ndërmjet departamenteve kanë ndodhur si pasojë e vendimeve gjyqësore. Në kategorinë paga, 1,460,225.00€ janë marrë për vendime gjyqësore dhe kontrata kolektive. Ku 90% e lëvizjeve janë për kontrata kolektive, përveç dy operatorëve, për arsye se është mbyllur kodi ekonomik i atij projekti. Të gjitha të tjerat janë për kontrata kolektive. Prej kategorisë ekonomike Mallra dhe Shërbime - Furnizim me veshmbathje për zjarrfikësit, nga shuma 4,993.00€, shuma 4,000.00€ janë marrë për zjarrfikësit dhe 993.00€ janë marrë nga Shërbimet publike, sepse vendimet gjyqësore kanë prekur tek mallrat 142,788.79€ dhe e kanë prishur balancën dhe pastaj ka pasur nevojë për zgjidhje. Po ashtu, edhe këtë vit janë prekur kodet ekonomike për arsye të vendimeve gjyqësore. Në këtë rast, është prekur kodi ekonomik Komunal i në vlerë prej: 8,890.00€. Nga Subvencionet janë shpenzuar 41,979.00€ dhe nga Projektet Kapitale janë shpenzuar 1,663,000.00€. Kolegu, z. Durim Hajra, e parashtrori pyetjen për 73% të shpenzuar në Investimet Kapitale në Drejtorinë e Kulturës dhe 55% të shpenzimeve në Drejtorinë e Urbanizmit. Ndërsa, nga Projektet Kapitale të

Drejtorisë së Kulturës, Ndërtimi i bibliotekës, ndërtimi i muzeut të qytetit dhe ndërtimi i galerive janë marrë për vendim gjyqësor. Shuma e mjeteve prej 200.000€ nga Ndërtimi i bibliotekës, 29,905.64€ nga Ndërtimi i Muzeut 29,532.46€ nga Ndërtimi i Galerisë. Kryetari nuk i ka marrë këto mjete, por kryetari ka një staf dhe të gjithë ata që janë në listën e pagave të kryetarit, e shfrytëzojnë kodin buxhetor 66002 - Zyra e Kryetarit. Kolegët parashtruan edhe pyetjen për Shërbimet e veçanta, konsulent dhe kontraktor individual në shumën prej: 7,300.00€. Kjo pagesë është bërë për ekspertin i cili është caktuar për Rregulloren e brendshme dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale. Shtesat tranzitore në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje janë të rregulluara me ligj, ku ju takon të gjithëve atyre që janë prekur pas hytjes së ligjit në fuqi. Po ashtu, edhe shtesat jashtë orarit të punës janë të rregulluara me ligj. Nga Projekti Kapital 'Asfaltimi në fshatin Lismir, rrugët 'Gojnovci', 'Ymer Sfarqa', 'Tahir Meha', 'Ejup Gashi', 'Konjuhi', 'Obërtinca', prej këtyre ka përfunduar vetëm ruga 'Unaza'. Po ashtu, dua ta sqaroj kolegun, z. Mirsad Qyqalla, që thesari nuk na ka pyetur ku t'i marrim paratë në cilin departament. Vendimet gjyqësore nuk paguhën nga Komuna.

Pika e pestë (5) - Propozim për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin në objekt për Arkivin Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin në objekt për Arkivin Komunal'. Hap diskutimin.

Laureat Gojnovci: Dje në Komitetin për Politikë dhe Financa, të gjithë anëtarët e komitetit kemi qenë të pajtimit që ky objekt duhet të marrë një status. Ligji na obligon të kemi një Arkiv Komunal, dhe e kemi konsideruar të arsyeshme që në fshatin Pomozotin, në objektin e vjetër të Shkollës Fillore 'Zejnel Salihu', të krijohet ky arkiv. Në buxhetin e vitit 2025 është paraparë për renovimin e këtij objekti, shuma e mjeteve financiare prej: 60,000.00€. Unë ju ftoj të gjithëve të votoni për këtë, sepse Komuna e Fushë-Kosovës ka nevojë për një arkiv komunal.

Durim Hajra: Ne si grup nuk e mbështesim këtë propozim, sepse ka vetëm pak kohë që janë shpenzuar 20,000.00€ për renovimin e një objekti për këtë qëllim dhe më duket i paarsyeshëm.

Mirsad Qyqalla: Unë personalisht e kam vizituar këtë objekt dhe kam thënë që urgjentisht duhet të rrenohet, për arsye të disa dukurive negative që po krijohen. Kjo është kërkesë edhe e banorëve të fshatit. Unë edhe në Komitet e kam thënë që grupi ynë nuk mund të jetë pjesë e këtij votimi, sepse shuma për këtë është e pamjaftueshme dhe vetëm nëse fillohet dhe nuk përfundon, nuk jemi të pajtimit. Jemi për, por jo në këtë mënyrë.

Hasan Ismajli: Me ju duhet një Arkiv i qytetit, këta kishin qenë më seriozë, por kjo është vetëm një mënyrë për të shpenzuar para këtu dhe nëse munden, t'i marrin disa dokumente dhe t'i dërgojnë atje, ku mund të shkatërrohen nga lagështia ose të hyjë dikush dhe t'i vjedhë dhe pastaj të thonë se dokumentet janë vjedhur, sepse frika më e madhe e këtyre është mos po u'a kërkon dikush. Nuk mund të rinovohet ai objekt pa pasur një projekt të fizibilitetit, sepse ai objekt nuk ka izolim, muret janë me tulla dhe ai objekt nuk i plotëson kushtet për rinovim. Arkiva e qytetit duhet të ketë siguri. A është ndarë buxheti për të pasur punëtorë që ta mbajnë 24 orë? Nëse jeni të interesuar për të rregulluar një objekt për arkiv të qytetit, ejani dhe të përgatitemi. Ne e kemi vetëm një propozim, asgjë tjetër nuk kemi. Ky propozim është i mangët.

Vlonjat Hasani: Ne në Komitetin për Politikë dhe Financa, nuk jemi dakorduar për këtë objekt, por jemi dakorduar që është i nevojshëm një vend për arkiv në Komunën e Fushë-Kosovës, por jo për këtë objekt. Kur komuna dëshiron t'i keqpërdorë këto objekte, gjen këto arsyeime. Kolegët më herët thanë se duhet të ketë një fizibilitet, të paktën të dihet nëse ai plotëson kushtet apo jo, por

një gjë që është shumë e rëndësishme, është që as nuk na është dhënë një prezantim në lidhje me komunitetin e asaj pjese. A keni biseduar me ta, a i keni pyetur se çfarë dëshirojnë të bëjnë me këtë objekt? I njëjti rast është edhe me objektin e shtëpisë së kulturës në fshatin Miradi e Epërme. Kështu u mor vendimi për të rrënuar, u rrënuar, u uzurpua dhe askush nuk ka reaguar. Në Komunën tonë, ka objekte të mjaftueshme, të cilat nuk janë duke u përdorur për asgjë dhe mund të transferohet arkiva komunale dhe kjo mund të realizohet. A keni biseduar me Arkivën Shtetërore për këtë çështje? A plotësohen kushtet dhe a është e përshtatshme?

Fisnik Sllamniku: Ne jemi vetëm në ndërrimin e destinimit, nga shkolla në arkiv komunale, arkiv i komunës, jo arkiv i qytetit. Mbetjet që i kemi të vjetra, duhet ose t'i rrënojmë ose t'i rinovojmë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Që dymbëdhjetë vjet, kam kërkuar që t'i bëhet zgjidhje atij vendi, sepse aty ushtrohet prostitucioni, përdorim substancash narkotike, rrahje dhe shumë gjëra të tjera. Kam bërë edhe video atje. A na garantoni që me shumën e mjeteve financiare prej: 60,000.00€, mundeni të bëni funksionale këtë arkiv? Sepse edhe Forca e Sigurisë së Kosovës ka bërë ushtrime aty dhe ajo është në gjendje të tmerrshme. A është kjo shumën prej: 60,000.00€ vetëm për këtë vit dhe vitin tjetër një pjesë tjetër? Sepse nëse janë vetëm 60,000.00€, unë këtë nuk e votoj.

Laureat Gojnovci: Nënkryetari dhe në Komitetin për Politikë dhe Financa është pajtuar që 60,000.00€ nuk mjaftojnë, por do të bëhet edhe një kontratë kornizë në vitin 2026, nëse nuk ndodh rishikimi i buxhetit brenda këtij viti.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nënkryetari ka ardhur, na ka premtuar që do të rregullojë mikrofonat dhe shumë gjëra të tjera dhe që dy vjet nuk ka pasur asnjë lëvizje. Nuk i ka mbajtur premtimet.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve: Kjo shumë e mjeteve financiare prej: 60,000.00€ është vetëm për vitin 2025, por sigurisht që do të jetë e planifikuar edhe për vitin 2026, sepse ky arkiv nuk mund të finalizohet me 60,000.00€. Sipas informatave që i kemi, ky arkiv do të jetë sipas standardeve që plotësojnë kërkesat për një arkiv.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e vuri në votim për aprovim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin në objekt për Arkivin Komunal'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', nuk ka vota 'kundër' dhe asnjë abstenime, gjithsej trembëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.


Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, në mungesë të votave nuk kalon 'Propozimi për ndërrimin e destinimit të shfrytëzimit të objektit të vjetër të shkollës në fshatin Pomozotin në objekt për Arkivin Komunal'.

Pika e gjashtë (6) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:50h.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevc



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

